

Galeria e Arteve e Kosovës nuk ia del ta organizojë këtë vit ekspozitën tradicionale

Hapet konkursi "Çmimi Muslim Mulliqi", ekspozita shtyhet për mot

"Tendencat e reja në artin pamor shqiptar" është koncepti kuratorial, në bazë të të cilit artistët që punojnë në pikturë, skulpturë, grafikë, instalacion, video-art, e degë të tjera të artit pamor, do t'i futen garës për çmimin më prestigjioz në këtë fushë të artit që ndahet në Kosovë. Ekspozita e cila tradicionalisht është hapur në fund të vitit, në mungesë të mjeteve, është shtyrë për fillimin e vitit që vjen

VULLNET KRASNIQI

PRISHTINË, 6 NËNTOR - Ekspozita ndërkombëtare e Galerisë së Arteve të Kosovës, "Çmimi Muslim Mulliqi" do ta thyjë traditën e saj. Ekspozita e cila tradicionalisht mbahet në fundvit, në edicionin e tetë të saj është shtyrë për vitin e ardhshëm. Ekspozita garuese do të mbahet në janar, ndërsa për këtë institucionin më i lart i artit pamor në vend, tashmë ka hapur konkursin. "Tendencat e reja në artin pamor shqiptar" është koncepti kuratorial, në bazë të të cilit artistët që punojnë në pikturë, skulpturë, grafikë, instalacion, video-art, e degë të tjera të artit pamor, do t'i futen garës për çmimin më prestigjioz në këtë fushë të artit që ndahet në Kosovë. Edhe këtë vit shpërblimi për fituesin do të jetë tre mijë euro. Qëllimi i edicionit të sivjetmë të ekspozitës "Çmimi Muslim Mulliqi", sipas konceptit kuratorial të bërë publik të shtunën, konsiston në nevojën e domosdoshme që të aktualizojë, por edhe të evidentojë synimet, përkatësisht tendencat risimtare në skenën artistike gjithëshqiptare.

"Artistët më nuk merren me inventarizimin e ndodhive historike, me aktualizimin e temave dhe përmbajtjeve të së kaluarës. Ata shikojnë vetëm përpara, të vetëdijshëm se vetëm një shikim i tillë i shpie drejt rrugës së risive dhe të arketipave artistikë, drejt së vërtetës", thuhet ndër të tjera në konceptin kuratorial. I pari i GAK-ut, Fahredin Spahija, ka thënë se konkursi me këtë koncept, fton gjithë krijuesit që e ndiejnë veten "në hap" me lëvizjet moderne të artit pamor në botë.

"Ajo çka tentohet me këtë edicion të këtij konkursi është, mbledhja nën një çati e të gjithë artistëve pamorë shqiptarë të cilët kanë arritur ta ruajnë identitetin e tyre krijues dhe veprën e tyre, pa oscilime të mëdha, duke e orientuar atë nga tendencat e reja të artit pamor", ka thënë Spahija.

Kritiku i artit, Mustafa Ferizi, ka thënë se ka lexuar me kujdes konceptin e edicionit të sivjetmë dhe se atij nuk ka se çka i shtohet as edhe një presje.

"Ishte shumë i qartë dhe udhëzimi se si duhet të marrin pjesë artistët", ka thënë Ferizi, teksa ka potencuar nevojën që të identifikohen tendencat e reja në artin shqiptar.

"Duhet t'i kushtojmë vetes më shumë respekt, si me pjesëmarrje të artistëve ashtu edhe në pasqyrimin e asaj se çka po ndodh sot në skenën e artit pamor kudo në shqiptari", ka shtuar Ferizi.

Në anën tjetër, mungesa e mjeteve është njëra nga arsyet që ka shtyrë GAK-un të ndërrojë datën e ekspozitës "Çmimi Muslim Mulliqi". Drejtori i GAK-ut Fahredin Spahija, krahas mungesës së mjeteve ka përmendur edhe një arsye të dytë.

"Konkursi 'Çmimi Muslim Mulliqi' është dashur të shpallej qysh në fillim të shtatorit, por për shkaqe bux-



Instalacioni "Bikini për pavarësi" me të cilin Antigona Selmani, Loreta Ukshini dhe Malësor Bejta u shpallën më të mirët në "Çmimi Muslim Mulliqi"

hetore ne u detyruam të presim deri në një përgjigje nga MKRS-ja dhe pasi i morëm paratë ky organizim do të zhvendoset për në janar të vitit 2011. Tjetër arsye është edhe ajo që ne dëshirojmë që artistëve pamorë t'u jepet mundësia të përgatiten sa më mirë", ka thënë Spahija, sipas të cilit "Muslim Mulliqi" është një organizim që kërkon edhe kohë.

Tek në tetor GAK-u ka përfituar 48 mijë euro shtesë (krahas 70 mijë eurove sa i janë ndarë në fillim të vitit) nga buxheti prej 150 mijë eurosh sa ka ndarë Ministria e Kulturës për katër institucione kulturore. Vitin e kaluar ekspozita "Çmimi Muslim Mulliqi" që mbajtur më 15 dhjetor me pjesëmarrjen e 25 artistëve vendës dhe ndërkombëtar, ndërsa tema e saj kishte qenë "Ndalet në çdo stacion". Fitues i shpërblimit prej tre mijë eurosh ka qenë vepra e përbashkët e artistëve të rinj Antigona Selmani, Loreta Ukshini dhe Malësor Bejta. Instalacioni "Bikini për pavarësi" kanë qenë një palë bikini gjigante që sipas autorëve ka përshkruar shtetin e ri.

Antigona Selmani, pjesë e treshes fituese, ka thënë se gjatë këtyre ditëve kanë qenë në pritje të konkursit. "Do të ulemi dhe do të lexojmë me kujdes konceptin, e të shohim nëse do të na përshtatet të punojmë sërish diçka të përbashkët", ka thënë Selmani, teksa shprehet të ripërsëritë suksesin e vitit të kaluar.

"Në të kundërtën do të shikoj se çka mund të bëjë vetë", ka thënë Selmani.

Ekspozita Ndërkombëtare "Çmimi Muslim Mulliqi" ka filluar që nga viti 2003 ku artistët si Jakup Ferri, Lulzim Zeqiri, Dren Maliqi, Mario Rizzi, Alban Hajdinaj, Ismet Jonuzi, Blerim Glloku, Jae Pas dhe shumë të tjerë janë shpërbluar me çmimin e parë. Që nga viti 2005 deri para dy vitesh temat e kësaj ekspozite kanë pasur të bëjnë me hapësirën publike, konformiste dhe disiplinore.

Vazhdon maratona e shfaqjes së performancës muzikore të nxënësve

"Prek Jakova" të Gjakovës

Mjuzikli "Oliver Twist" shfaqet në kryeqytet

PRISHTINË, 6 NËNTOR - Skena e Teatrit Kombëtar të Kosovës është mbushur plot fëmijë, të cilët kanë "zbratur" talentin e tyre në këndim dhe aktrim. Një orkestër muzikore i ka kontribuar edhe më shumë inskenimit të mjuziklit "Oliver Twist", i realizuar nga nxënësit e shkollës së muzikës "Prek Jakova" në Gjakovë, në regji të zviceranit George Davash. Mjuzikli është dhënë premierë në fund të tetorit në Gjakovë.

"Oliver..." i cili shtjellon historinë e jetimit Oliver Twist, protagonistin e librit të njohur të shkrimtarit anglez Çarls Dickens, është duartrokur nga

publiku prishtinas. Mirjeta Hoxha, studente e solokëndimit në Fakultetin e Arteve në Prishtinë, është shprehur e impresionuar me performancën e fëmijëve gjakovarë.

"Mua më ka lënë përshtypje guximi i tyre për t'u ngjitur në skenë dhe për të bërë atë që dinë më së miri", ka thënë ajo, duke lavdëruar lojën e aktorit të vogël, i cili luan rolin e jetimit, Leon Berisha. Menjëherë pas shfaqjes Berisha ka thënë se ndihet i lumtur që performoi edhe para publikut të Prishtinës.

"Në Gjakovë ka shkuar mirë. Por edhe më mirë ka shkuar në

Prishtinë. Këtu jam ndier tamam aktor, sepse edhe skena ka qenë shumë e madhe", ka thënë ai. Ndryshe, shfaqja me regji të George Davash në të cilën luajnë edhe këngëtarja Yllka Kuçi dhe aktori Hysen Binaku, si dhe profesorët e shkollës, Astrit Pallaska e Pllumb Vula, të cilët bashkë me zviceranin Johanes Grener janë përkujdesur për muzikën e interpretuar nga orkestra e Shkollës së Muzikës në Gjakovë.

Para Prishtinës mjuzikli "Oliver Twist" është dhënë edhe para publikut të Pejës dhe të Prizrenit.

V. Krasniqi

Përmbillet edicioni i gjashtë i festivalit të vetëm të jazz muzikës në Kosovë

"Prishtina Jazz Festival" kulmon me performancën e Elina Dunit

Elina Duni i këndoi dashurisë të shtunën mbrëma në Prishtinë. Biletat për koncertin e saj u shitën 24 orë përpara, ndërsa për 120 minuta ajo i ktheu në jazz edhe motrat Mustafa. Tutje ajo udhëtoi nga jugu i Shqipërisë në veri të Rumanisë e të Bullgarisë, në këngët mesdhetare të Turqisë dhe u ndal në malet e Kosovës për "Bareshën". Ilir Bajri, drejtor i festivalit, tha se kjo që ka ndodhur për pesë ditë në "Prishtina jazz festival" është magji, që vetëm kjo muzikë di ta bëjë



VULLNET KRASNIQI

PRISHTINË, 6 NËNTOR - Kënga veriore bullgare "Kaval" e ka bërë të qante bullgaren Milena Teskov, e cila si kujtim të vetëm nga gjyshja e saj e ka këtë këngë. Grekja Addie Katarevousa është kthyer duarthatë dhe e dëshpëruar të shtunën në mesditë nga teatri "Oda", pasi nuk ka arritur që të gjente bileta për koncertin e fundit të "Prishtina Jazz Festival", të cilat janë shitur një ditë përpara. Burim Aliu kurrë nuk e kishte menduar se një këngë e motrave Mustafa nga Mushtishtit i Suharekës do të mund të kthehej në jazz.

Elina Duni nga Shqipëria së bashku me treshen zvicerane janë "fajtorët" e gjithë kësaj "rrëmuje" të shkaktuar të shtunën në teatrin "Oda", ku edhe u mbyll edicioni i gjashtë i festivalit të muzikës jazz "Prishtina jazz festival". Plot 11 këngë me emocion dhe ndjenjë ndaj dashurisë, në shumicën e gjuhëve ballkanase, kanë qenë pjesë e repertorit të "Elina Duni Quartet" që la pa fjalë afro 300 veta, të cilët kishin stërmbushur hapësirën e vogël të "Odës".

"Hapi sytë", "U rrit vasha", "Spaske pas një pikë mëshirë", "E mora çiften" së bashku me hitin e Nexhmije Pagarushës, "Baresha", kanë qenë disa nga këngët që "Elina..." i kishte përzgjedhur t'i këndonte në mënyrën më të ndjeshme që muzika jazz e ofron. Mirëpo askush nuk e kishte pritur që në jazz mund të kthehej "Mollë e ndalueme" e dy motrave Mustafa. Por Duni e interpretoi atë në stilin e Nina Simone.

"Unë kam një surprizë për ju sonte. Kam shikuar shumë në internet të gjeja një këngë të dy motrave që flet për guximin e një djali që me çdo kusht e dëshiron një femër, edhe në qoftë se ajo është mollë e ndaluar", i është drejtuar Duni publikut.

Ajo ka kënduar edhe "Kaval", një

histori që flet për një grua që është e dashuruar në një njeri që luan me kavall, në një fshat të largët bullgar, dhe së bashku me këtë përmes "Lume lume" i ka kënduar dashurisë ndaj jetës dhe dhimbjes kur ajo përfundon, që në Rumuni është një hit i muzikës folklorike. Për Dunin, lajmi se biletat për koncertin e saj janë shitur një ditë më parë, dhe vetë performimi në Prishtinë është një emocion i veçantë. "Ky koncert është i rëndësishëm", ka thënë Duni, duke treguar edhe arsyet se përse ka përzgjedhur pikërisht këngët folklorike shqiptare dhe ballkanase t'i kthejë në jazz. "Folklori shqiptar është shumë elastik dhe janë disa këngë që njëmend mund të kthehen në jazz dhe madje në mënyrë shumë të bukur. Në përgjithësi muzika në Ballkan është unike, por muzika shqiptare është më e mira, sepse ka shumë kolorit", thotë Duni, e cila së bashku me Colin Valon në piano, Patrice Moret në kontrabas dhe Nobert Pfammatter në tupana, kanë bërë "magji" në "Odë". Pianisti Colin, i cili në vitin 2004 i kishte propozuar Dunit që së bashku ta bënin një projekt muzikor që këngët ballkanike t'i kthenin në jazz, ka thënë se performimi i ka dhënë emocion. "Është diçka shumë e bukur kjo që po ndodh në Prishtinë", ka thënë ai.

Ndryshe, drejtori i "Prishtina...", Ilir Bajri, është shprehur se ky edicion ka pasur prurje cilësore të benedeve, publik të kulturuar dhe shumë mysafirë. "Kam qenë skeptik se si do të dalë. Mirëpo, kjo që ka ndodhur për këto ditë është diçka e mrekullueshme që vetëm në jazz mund të ndodhë", ka thënë ai. Në kuadër të këtij edicioni të "Prishtina Jazz Festival" kanë performuar jazz muzikantët: "Daniele Esposito Trio", "Fjoralba Turku Quartet", "Crazy People Music" dhe "Francesco D'Errico Group".